


Hepatiti C, sot shërohet !

Version albanais




Hepatiti C është një virus i cili prek mëlçinë tuaj. Mëlçia është një organ vital për trupin tonë. Në rast se ajo është e sëmurë, ajo nuk mund të funksionojë korrektësisht.

Shpesh, ju i ndjeni pak ose aspak simptomat. Në rast se sëmundja nuk trajtohet shpejt, kjo sëmundje mund të ketë pasoja të rënda për shëndetin tuaj.



Hepatiti C transmetohet nëpërmjet kontaktit gjak me gjak. Që virusi të kalojë nga një trup te tjetri, duhet që të ketë një « portë të hyrjes » në trup (një pikë injektimi me shiringë, një organ seksuale, etj.), nëpërmjet gjakut.



Për të shmangur kontaminimin, mos përdorni materialin (e higjienës, të tatuazhit, të konsumimit të drogës, etj.) të personave të tjerë dhe shmangini marrëdhëniet seksuale të pambrojtura.



Për tu mbrojtur, përdorni materialin tuaj vetjak ose material të ri dhe prezervativ të ri gjatë marrëdhënieve seksuale (sidomos ato anale).

Përkundrazi, ju mund të bashkëjetoni me dikë ose ta përqafoni atë, të shtrëngoni dorën ose të ndani me njëri tjetrin të njëjtën gotë ose ushqimin tuaj pa asnjë rrezik.

I.Care
collectif RD engagé

INK LINK

Projet réalisé avec le soutien du Fonds Dr. Daniël De Coninck, géré par la Fondation Roi Baudouin

Hepatiti C, sot shërohet !

Version albanais



Për të ditur nëse jini i sëmurë, ju duhet të ekzaminoheni. Ekzaminimi bëhet nëpërmjet marrjes së gjakut. Marrja e gjakut do të bëjë të mundur që të dini nëse ju keni qenë më përpara në kontakt me virusin.



Në rast se është kështu, duhen bërë ekzaminime të tjera për të ditur nëse ju jini i sëmurë aktualisht. Këto ekzaminime janë pak të dhimshëm.



Trajtimi mund të merret edhe në rastin kur konsumohet drogë ose alkool.

Sot, ekziston një trajtim shumë rezultativ dhe me pak efekte sekondare, me tableta, të cilat duhen marrë çdo ditë, për kohën 2 deri në 3 muaj. Merrini të gjitha tabletat dhe në të njëjtën orë, për të rritur mundësitë tuaja për shërim.



Pas shërimit, është e mundur të infektoheni përsëri. Pra mbrohuni dhe kërkojini një mjekun ose një infermiereje që t'ju ekzaminonjë rregullisht.